



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.58/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, me seli në Drenas, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 26.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa e subjektit politik, Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, me seli në Drenas, ZL.Anr.58/2025, e datës 24.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 24.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.58/2025, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, me seli në Drenas, me te cilën pretendon se më datë 24.09.2025, përmes palëve të treta është njoftuar me përmbajtjen e disa komunikimeve që janë dërguar si screenshot-a. Në ato materiale shihet se si Kryetari i nëndegës së PDK-së në Balincë, Komuna Malishevë, z. Sahit Kastrati, ka kontaktuar qytetarët e Komunës së Drenasit, pa qenë në shoqëri me ta, me kërkesën që të mos t'i japin pëlqime (like) Ramiz Lladrovci pasi që *"nuk ja ninë as për Hashim Thaqin, as për Kadri Veselin dhe as për Jakup Krasniqin por e ka të errësuar trurin vetëm për karrike me diktatur dhe bajraktarizëm të shfrenuar"*, pas kësaj kur pyetet se për kë duhet dhënë pëlqimet personi i sugjeron Petrit Hajdarin. Me këtë ai dhe subjekti të cilin ai përfaqëson ka shkelur Ligjin Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 4, paragrafi 1, pika 1.3 dhe 1.10 si dhe nenin 34, paragrafi I, pika 1.7 dhe 1.11. Me këtë kërkojmë nga PZAP të japë ndëshkime të cilat do të diskurajonin personat e tillë të ndërmerrnin veprime të ngjashme.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi të cilat tregojnë mesazhet e bisedës në rrjetin social "Messenger" dhe një postim të vitit 2019 në Facebook.

Në përgjigje në ankesë, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar se veprim dhe denoncimi i PDKRLL nuk përbën asnjë shkelje të ligjit sepse ankuesi nuk ofron asnjë fakt që të tregojë se kur është kryer veprimi që ai e konsideron të paligjshëm. Nga shqyrtimi i ankesës dhe pretendimeve të paraqitura, konstatohet se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë lidhur me kohën e kryerjes së veprimit të pretenduar si të paligjshëm, gjë që pamundëson verifikimin e përmbushjes së afatit ligjor prej 48 orësh për paraqitjen e ankesës. Po ashtu, nga përmbajtja e pretendimeve nuk rezulton të jetë shkelur ndonjë dispozitë e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, pasi nuk ka elementë të pengimit të votimit, as përmbajtje të gjuhës së urrejtjes apo nxitjes së dhunës. Për rrjedhojë, i propozojmë PZAP të refuzoj ankesën si të pabazuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka mundur të argumentohet me asnjë provë, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Bazuar në këtë subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovci, përmes fotografive të bashkangjitur nuk ka konstatuar kohën e kryerjes së veprimit, si rrjedhojë nuk mund të verifikohet përmbushja e afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Andaj, në mungesë të provave Paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.58/2025 datë 26.09.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.